



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade



01 ref. 45
08.10.2021

Mbështetur në nenet 92.4 dhe 93(4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, nenin 39 paragrafët 1, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 04/L-240 për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese, si dhe nenin 8.1.4 dhe shtojcën 12 të Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë nxjerr këtë:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E MASËS MBROJTËSE ANTIDAMPING NË IMPORTIN E KONCENTRATIT PËR SHPEZË DHE KAFSHË NGA SERBIA

1. **Caktohet** masë mbrojtëse e përkohshme antidamping prej tre eurocentë (0,03 €) për kilogram në importin e të gjitha llojeve të koncentratit për shpezë dhe kafshë me origjinë nga Serbia, të përfshira në kodin tarifor 2309905100.
2. Masa nga pika 1 e këtij vendimi caktohet ndaj këtyre subjekteve eksportuese:
 - 2.1. FSH “Jabuka” doo Pančevo – Trg Maršala Tita 63, Glogonj 304316, Serbi;
 - 2.2. “Gebi” doo – Maršala Tita 46, 24220 Čantavir, Serbi;
 - 2.3. FSH “Sto posto” doo – Staro Selo, Velika Plana, Serbi;
 - 2.4. FSH “Bečejka” doo – Novosadska 163, 21220 Bečej, Serbi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Pas kërkesës së prodhuesve vendorë dhe propozimit të Komisionit për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta në Importe, Departamenti i Tregtisë ka filluar hetimin e importit nga Serbia dhe të shitjes në tregun e Republikës së Kosovës të koncentratit për shpezë dhe kafshë. Hetimi është kryer në përputhje me Ligjin për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese.

Departamenti ka gjetur se koncentratit për shpezë dhe kafshë me origjinë nga Serbia shitet me çmime më të ulëta në tregun e Republikës së Kosovës sesa në tregun e brendshëm të Serbisë. Kjo praktikë nxit importin, duke dëmtuar drejtpërdrejt dhe çdo herë e më shumë prodhuesin vendor.

Rrjedhimisht, pas konsultimit me Komisionin dhe duke u thirrur në paragrafët 1, 4 dhe 6 të nenit 36 të Ligjit, Departamenti ka rekomanduar vendosjen e masës mbrojtëse antidamping si në dispozitiv.

Këshillë juridike: Ky vendim është akt përfundimtar në procedurën administrative. Pala e pakënaqur mund të nisë konflikt administrativ në gjykatën kompetente.

 Rozeta HAJDARI

Ministre

U dërgohet:

- Kabinetit
- Doganës
- Anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta në Importe
- Sekretarit të Përgjithshëm
- Departamentit të Tregtisë
- Departamentit Ligjor
- Arkivit